



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Përgjigjet ndaj Komenteve (KEK)

Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike

SHTE6 (2012-2013)

Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara

DEKLARATË

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

20 qershor 2012

Tabela e përmbajtjes

1	Hyrje	1
2	Struktura e këtij dokumenti	1
3	Sigurimi i transparencës	2
3.1	Thurja e kostove	2
3.2	Lëvizja në drejtim të tarifave që reflektojnë koston	2
3.3	Qartësimi i bilancit të energjisë.....	3
3.4	Qartësimi mbi të hyrat e lejuara	4
4	Komentet e KEK-ut mbi qëndrimin e ZRRE-së	4
4.1	Pikat e pajtimit të përgjithshëm	4
4.2	Axhustimet e kontestuara nga KEK-u	4
4.2.1	Mungesa e qartësisë në përcaktimin e kostove kapitale	4
4.2.2	Llogaritja e pasaktë e kostove të pashpenzuara operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2011 ...	5
4.2.3	Zbritja jo e duhur e të hyrave të lejuara për KEK-un për 2012 për ngarkesat e transmisionit të vitit 2010	6
5	Çështje të tjera	7
5.1	Shpenzimet kapitale nga divizioni i gjenerimit	7
5.2	Transferi i asetëve 110kV	7
5.3	Rritja e tantimës për thëngjill	8
6	Komentet tjera	8
6.1	OJQ Konsumatori	8
6.2	SHUKOS	10
6.3	Shoqata e Mullistëve të Kosovës	10
7	Të hyrat e lejuara të propozuara si dhe rritja mesatare e nevojshme e tarifës	11
8	Tarifat e reja të propozuara	14

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE6).

Ky Dokument jep përgjigjet e ZRRE-së ndaj komenteve të pranuar lidhur me Raportin Konsultativ, të lëshuar përkitazi me aplikacionet që i janë dorëzuar ZRRE-së nga Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) për të aprovuar propozimet vijuese:

- Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që mund të mblidhen nga bizneset e licencuara të Gjenerimit dhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë¹ të cilat do t'i aplikojë biznesi i licencuar i Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (FPEE), të cilat e mbulojnë koston e afarizmit të këtij biznesi, që i caktohen konsumatorëve të rregulluar.

Aplikacionet e pranuar janë botuar në ueb faqen e ZRRE-së së bashku me Raportin Konsultativ, komentet e pranuar nga palët e interesit si dhe këtë Dokument të përgjigjeve.

Qëllimi i këtij Dokumenti është që t'u komunikojë palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me komentet e pranuar si dhe propozimet e ZRRE-së lidhur me të hyrat maksimale të lejuara dhe tarifat e rregulluara. Këto draft propozime do të shqyrtohen nga Bordi i ZRRE-së në takimin publik para lëshimit të vendimit.

Vendimi i lëshuar nga ZRRE do të përcaktojë MAR-in për bizneset e Gjenerimit dhe të OSSH-së e KEK dhe tarifat e rregulluara të shitjes me pakicë të cilat do t'i aplikojë biznesi i FPEE-së në kuadër të KEK-ut. Tarifat të cilat do t'i aplikojnë bizneset e Gjenerimit dhe të OSSH-së në KEK do të përcaktohen nga licenca relevante, me kusht që këto të jenë në përputhje me metodologjitë e përcaktimit të ngarkesave të miratuara nga ZRRE.

2 Struktura e këtij dokumenti

KEK-u ka parashtruar komente të hollësishme lidhur me shqyrtimin dhe propozimet fillestare të ZRRE-së. Komente gjithashtu janë dhënë nga OJQ-ja Konsumatori, SHUKOS (Shoqata e ujësjellësve dhe kanalizimit të Kosovës) dhe Shoqata e Mullisëve të Kosovës². Duke pasur parasysh këtë, për

¹ Tarifat e rregulluara me pakicë aplikohen te konsumatorët e pa kualifikuar dhe konsumatorët e kualifikuar kur ZRRE përcakton se konkurenca efektive për furnizim nuk ekziston. Aktualisht, të githë konsumatorët në Kosovë shërbehen nga FPEE me tarifen e rregulluar me pakicë.

² Komentet nga të tre organizatat janë pranuar pas afatit kohor për parashtrim. Mirëpo, duke marrë parasysh mungesën e komenteve nga konsumatorë të tjerë, ZRRE ka vendosur që t'i pranojë këto komente si komente që përfaqësojnë brengat e konsumatorëve.

qëllime të lehtësimit, ky Dokument është organizuar sipas titujve të komenteve të KEK-ut, ku komentet e OJQ-së Konsumatori dhe SHUKOS-it diskutohen pas komenteve të KEK-ut. **Përdorimi i këtyre titujve për lehtësi të lexuesit nuk nënkupton pajtimin e ZRRE-së me pikëpamjet e shprehura.** Për çdo titull, argumentet e prezantuara nga KEK-u jepen të përmbledhura dhe përcillen nga përgjigjet e ZRRE-së ndaj tyre. Lexuesit mund t'iu referohen komenteve të ofruara nga KEK-u për informata më të plota³. Pjesët e fundit të dokumentit japin komentet e ZRRE-së mbi çështje të tjera që nuk janë përfshirë në përgjigjet e KEK-ut si dhe propozimet e ZRRE-së.

3 Sigurimi i transparencës

3.1 Thurja e kostove

KEK-u ka komentuar se ZRRE, në Raportin Konsultativ, është përqendruar vetëm në kostot e përgjithshme (ose të "thurura") dhe ndryshimin e nevojshëm të tarifave mesatare të shitjes me pakicë dhe nuk ka dhënë ndonjë propozim lidhur me MAR-in e veçantë për bizneset e gjenerimit dhe të OSSH-së. KEK-u gjithashtu ka komentuar se mungesa e një MAR-i të veçantë për OSSH nuk mbështet zhvillimin e konkurrencës së shitjes me pakicë, për të cilën gjë kërkohet një ngarkesë e veçantë distribucioni për konsumatorët të cilët kërkojnë furnizim të parregulluar.

ZRRE vë në pah se në vitet paraprake, ZRRE ka përcaktuar ngarkesa të veçanta për shpërndarje por KEK-u nuk i ka zbatuar këto, duke marrë parasysh se nuk ka konsumatorë të parregulluar të kyçur në tensionet e ndryshme të rrjetit të shpërndarjes. Prandaj, ZRRE, e konsideron si të paarsyeshme që KEK-u tash të pohojë se është i gatshëm të aplikojë ngarkesa të veçanta për shpërndarjen. ZRRE gjithashtu vë në pah se KEK-u në të kaluarën nuk ka propozuar ngarkesa të veçanta të rregulluara për gjenerim, e jo më t'i aplikojë këto.

Përkundër kësaj, ZRRE pajtohet se të hyrat maksimale të lejuara (MAR) të veçanta duhet të aprovohen për bizneset e gjenerimit dhe të OSSH-së. Pastaj, është në përgjegjësi të KEK-ut që t'i përcaktojë ngarkesat në përputhje me metodologjitë e aprovuara nga ZRRE.

3.2 Lëvizja në drejtim të tarifave që reflektojnë koston

KEK-u komenton se ZRRE nuk ka caktuar tarifën në nivele që pasqyrojnë koston. ZRRE vë në pah se në Raportin e vet Konsultativ ka cekur qartë se është duke kryer analizë të kostove të shërbimit për klasa të ndryshme të konsumatorëve, të cilat do të përdoren për të përcaktuar tarifa që pasqyrojnë koston. Ky studim do të identifikojë madhësinë e ndër-subvencionimit eventual të cilin ZRRE do ta përdorë për të lëvizur në drejtim të tarifave që reflektojnë koston, në pajtim me provizionet e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

³ "Përgjigje ndaj Raportit Konsultativ të ZRRE-së", KEK, 12 mars 2012. Në dispozicion nga uebfaqja e ZRRE-së në www.ero-ks.org në menynë Çmimet dhe Tarifat.

3.3 Qartësimi i bilancit të energjisë

KEK-u komenton se furnizimi i pafaturuar për veriun e Kosovës nuk duhet të konsiderohen si humbje në shpërndarje pasi që këto janë jashtë kontrollit të KEK-ut. KEK-u gjithashtu komenton se, pas privatizimit të KEDS-it, kostoja e këtyre humbjeve do të bie mbi KEK-un dhe ai duhet edhe t'i rikthejë.

ZRRE pajtohet se kostot e këtyre furnizimeve janë jashtë kontrollit të KEK-ut dhe janë një obligim i imponuar i cili duhet të kompensohet në tërësi. ZRRE gjithashtu pajtohet se këto kosto duhet të identifikohen ndaras në llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe ka bërë këtë në Dokumentin e vet të përgjigjeve. Mirëpo, kjo nuk ndryshon llogaritjen e të hyrave të lejuara në shqyrtimin aktual të tarifës.

ZRRE vë në pah se privatizimi i KEDS-it ende nuk është përmbyllur. Mirëpo, ZRRE vë në pah se, në mungesë të një subvencioni të Qeverisë, kostoja e këtij furnizimi të pafaturuar në fund do të duhet të rikthehen nga konsumatorë të energjisë elektrike në Kosovë pa marrë parasysh se cili i licencuar është përgjegjës për t'i paguar ato.

Tabela në vijim paraqet balancën e energjisë (shtylla e parë paraqet vlerat e kërkuara nga KEK ndërsa ajo e dyta paraqet vlerat e propozuara nga ZRRE) në të cilën është ndarë energjia e pafaturuar.

Tabela 1: Përmbledhja e bilancit të energjisë krahasuar me furnizimin e pafaturuar të ndarë

<i>GWh</i>	Kërkesa e KEK-ut	Propozimet e ZRRE-së
Furnizimi		
1. Neto prodhimi i KEK-ut ^a	4,868	4,868
2. Blerjet nga prodhues të tjerë në Kosovë	134	134
3. Importet	825	797
4. Furnizimi i përgjithshëm	5,826	5,798
Kërkesa		
5. Eksportet	170	184
6. Furnizimet e pafaturuar	204	204
7. Humbjet në transmision ^b	132	132
8. Humbjet në distribucion	1,520	1,399
9. Shfrytëzimi vetanak i KEK-ut ^c	145	131
10. Shitjet përfundimtare	3,656	3,748
11. Kërkesa totale	5,826	5,798
12. Humbjet në transmision ^d	2.3%	2.3%
13. Humbjet në shpërndarje (pa energjinë e pafaturuar) ^e	32.8%	30.4%

Shënim

Komentet e KEK-ut mbi qëndrimin e ZRRE-së

- a Neto prodhimi i KEK-ut përfaqëson totalin e prodhimit në pronësi të KEK-ut por duke zbritur energjinë elektrike që përdoret në konsumin ndihmës. KEK-u i prezanton këto ndaras në kërkesën e vet ndërsa ZRRE i kombinon në llogaritë e veta.
- b Propozimet e ZRRE-së përfshijnë ndikimin e transferimit të aseteve 110 kV nga OSSH e KEK-ut te KOSTT-i, që rezultojnë në rialokimin e humbjeve të asocuara te KOSTT-i si humbje në transmision (shih Pjesën 5.2).
- c Konsumi vetanak i KEK-ut përfaqëson energjinë elektrike të shpenzuar nga KEK-u në miniera dhe konsumin tjetër të brendshëm. Këtu përjashtohet konsumi ndihmës nga gjeneratorët në pronësi të KEK-ut.
- d E llogaritur si përqindja e energjisë që hyn në rrjetin e transmisionit. [(8 / 4) përjashton gjenerimin e kyçur në Shpërndarje prej 51.5 GWh]
- e E llogaritur si përqindja e energjisë që hyn në rrjetin e distribucionit. [8 / (8 + 10) përjashton konsumatorë të kyçur në transmision prej 744.5 GWh]

3.4 Qartësimi mbi të hyrat e lejuara

KEK-u komenton se nuk është në gjendje të identifikojë nga Raporti Konsultativ se cili është MAR-i i propozuar nga Rregullatori apo si është llogaritur rritja fillestare e propozuar prej 7.6% e tarifës mesatare të rregulluar të shitjes me pakicë. ZRRE e ka të vështirë të kuptojë këtë kur ka parasysh se, pas lëshimit të Raportit Konsultativ, KEK-ut i është dhënë një kopje elektronike e modelit tarifor (në Excel) që është për llogaritjet e ZRRE-së. Duket se KEK-u nuk e ka analizuar modelin. Sidoqoftë, në fund të këtij dokumenti, është dhënë një përmbledhje e llogaritjeve të ZRRE-së.

4 Komentet e KEK-ut mbi qëndrimin e ZRRE-së

4.1 Pikat e pajtimit të përgjithshëm

ZRRE nuk e sheh të arsyeshme t'u përgjigjet deklaratave të KEK-ut në këtë pjesë.

4.2 Axhustimet e kontestuara nga KEK-u

4.2.1 Mungesa e qartësisë në përcaktimin e kostove kapitale

KEK-u komenton se Raporti Konsultativ nuk përshkruan se si është përdorur Baza e Aseteve Rregullative e (RAB) për të përcaktuar normën e kthimit (apo fitimit) (RABf) si dhe lejimet për zhvlerësim. KEK-u gjithashtu konteston largimin e kthimit të lejuar tek asetet para 2006 nga ana e ZRRE-së.

ZRRE thekson se, ashtu siç është cekur në Pjesët 5.1 dhe 5.2 të Raportit Konsultativ, vlera e RAB, RABf dhe lejimet për zhvlerësim janë përcaktuar në përputhje me Raportet Konsultative të lëshuara nga ZRRE në vitin 2011 lidhur me këto çështje dhe vendimet pasuese të Bordit të ZRRE-së. KEK-ut i janë ofruar mundësi të bollshme për të komentuar atëherë, përfshirë edhe dorëzimin e llogaritjeve të ZRRE-së në formë të tabelarëve (Excel).

Sa i përket kthimit në asete para vitit 2006, ZRRE vazhdimisht ka deklaruar se nuk lejon kthimin në këto asete pasi që KEK-u nuk ka kosto financimi që lidhen me to. Prandaj, çfarëdo kthimi i lejuar do të paraqiste të hyra shtesë për KEK-un por pa kosto të asocuara. Kjo thjeshtë do të paraqiste një pagesë

shtesë nga konsumatorët e energjisë elektrike, gjë që nuk është e pranueshme nga Rregullatori. KEK-u, në komentet e dhëna, deklaroi se “KEK-u ka paguar për këto asete” (p7). Me sa është në dijeni ZRRE, këto asete paraqesin një kombinim të aseteve para vitit 1999 për të cilat KEK-u nuk ka bërë ndonjë pagesë pronarëve të tyre të mëhershëm dhe nuk ka as ndonjë borxh të marr përsipër përkitazi me ndërtimin e këtyre aseteve të ndërtuara ndërmjet vitit 1999 dhe 2006, të cilat gati në tërësi janë financuar nga grantet e donatorëve ndërkombëtarë. ZRRE fton KEK-un të ofrojë dëshmi të pagesave të cilat i ka bërë për këto asete dhe kostot e asocuara financiare të supozuara nga KEK-u.

ZRRE propozon të mos bëjë ndryshime në RAB, RABf dhe lejimet për zhvlerësim të përcaktuar me Raportin Konsultativ, me përjashtim të marrëveshjeve të transferimit të aseteve.

4.2.2 Llogaritja e pasaktë e kostove të pashpenzuara operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2011

KEK-u komentoi se ZRRE ka llogaritur pa saktë rregullimin për dallimet ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre të realizuara operative dhe të mirëmbajtjes (O&M) për bizneset e KEK-ut të mihjes, gjenerimit dhe OSSH-së në vitin 2011. KEK-u deklaroi se dallimi është më i ulët se ai i llogaritur nga ZRRE-ja pasi që ZRRE ka përdorur të dhëna jo të plota dhe nuk i ka përfshirë të gjitha kostot O&M të shkaktuara nga KEK-u. Duke përdorur llogaritë e pa audituara për vitin 2011⁴, KEK-u llogariti se dallimi ndërmjet kostove të lejuara dhe të realizuara O&M është 4 milionë euro, dhe jo 8.8 milionë euro të aplikuar nga ZRRE.

ZRRE vë në pah se bashkërendimet janë aplikuar për dallimet ndërmjet shpenzimeve të lejuara dhe të realizuara të mirëmbajtjes, dhe jo për të gjitha kostot O&M. Arsyeja për këtë është se ZRRE konsideron se buxheti i pashpenzuar kundrejt shpenzimit të parashikuar të mirëmbajtjes nënkupton ulje të cilësisë së shërbimit dhe KEK-u nuk duhet të shpërblehet për këtë. Pasi që KEK-u pohoi se disa shpenzime të mirëmbajtjes janë përfshirë në kosto të materialeve dhe shërbimeve, ZRRE ka aplikuar këtë barazim duke krahasuar shumën e lejuar për mirëmbajtje, materiale dhe shërbime me ato të raportuara nga KEK-u në vitin 2011. KEK-u nuk synon të barazojë kostot e tjera siç janë ato për punëtorë apo shpenzime komunale.

ZRRE ka rillogaritur axhustimet në bashkërenditje si në vijim, duke përdorur të dhënat e pa audituara të kontabilitetit të ofruara nga KEK-u. Shlyerja e inventarit në librat e kontabilitetit është dhënë si shpenzim i mirëmbajtjes dhe shpenzim materiale.

Tabela 2: Llogaritja e ndryshuar e barazimit të O&M

€ milionë	Raporti Konsultativ ^a	Dokumenti i përgjigjeve ^b	Dallimi
Kategoritë e përfshira të	Mirëmbajtja	Mirëmbajtja	

⁴ KEK-u ka kërkuar që këto llogaritë të pa audituara të mbahen si konfidenciale. Megjithatë, ky Dokument i përgjigjeve nuk përfshin zbatim të koston të ofruar.

Komentet e KEK-ut mbi qëndrimin e ZRRE-së

€ milionë	Raporti Konsultativ ^a	Dokumenti i përgjigjeve ^b	Dallimi
shpenz.	Materialet dhe furnizimet	Materialet dhe furnizimet Shlyerja e inventarit	
Reale	27.7	27.5	-0.2
Të lejuara	36.6	36.6	0.0
Barazimi	-8.9	-9.1	-0.2

Shënimet

a Të llogaritura duke përdorur kostot e ofruara nga KEK-u në kërkesën e tyre

b Të llogaritura duke përdorur kostot e ofruara nga KEK-u në formën e llogarive të pa audituara për vitin 2011

Duke marrë parasysh se llogaritë e pa audituara ofrojnë të dhëna pothuajse identike me ato që ZRRE ka përdorur në llogaritjet e veta në Raportin Konsultativ, ZRRE propozon që të mos bëhen ndryshime të rikonsilimeve për kostot materiale dhe të mirëmbajtjes.

4.2.3 Zbritja jo e duhur e të hyrave të lejuara për KEK-un për 2012 për ngarkesat e transmisionit të vitit 2010

KEK-u është në kontest me Operatorin e Sistemit të Transmisionit (KOSTT) lidhur me pagesat e vitit 2010. Kontesti i është referuar ZRRE-së, i cili në takimin e Bordit të mbajtur më 29 dhjetor 2011, ka lëshuar vendimin e tij⁵ se KEK-u i ka borxh një shumë të papaguar prej €3.88 milionë KOSTT-it dhe se kjo shumë duhet të zbritet nga të hyrat e lejuara të mbledhura nga FPEE përmes tarifave të rregulluara të shitjes me pakicë për 2012-13 (gjegjësisht, ato të përcaktuara me SHTE6). Në komentet e veta, KEK-u cek pikat e veta të mospajtimit me vendimin e ZRRE-së dhe cek se do ankohet ndaj vendimit në Gjykatën Supreme.

Ky Raport i përgjigjeve nuk është mjet i përshtatshëm për të hyrë në diskutim mbi vendimin e ZRRE-së, arsyet e të cilës janë shpjeguar në tërësi në vendimin e publikuar. Në vend të kësaj, çështje relevante për këtë Raport të përgjigjeve është nëse ankesa në Gjykatë Supreme nënkupton se vendimi i lëshuar nga ZRRE duhet të pezullohet deri në lëshimin e këtij vendimi nga gjykata.

Vlerësimi i ZRRE-së është se ankesa në gjykatën kompetente kundër vendimit të Bordit të ZRRE-së nuk e shfuqizon atë vendim apo nuk kërkon pezullimin e tij. Vendimi mbetet në fuqi ashtu siç është lëshuar përveç nëse gjykata vendosë që ai është i pavlefshëm apo të mos kërkojë amendamentim me ç'rast gjykata gjithashtu mund të kërkojë që palëve t'u paguhen dëmet që janë shkaktuar nga ky vendim. Duke marrë këtë parasysh, ZRRE do të vazhdojë që të zbatojë vendimin e lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.

ZRRE propozon që të vazhdojë zbatimin e Vendimit V_400_2012 në SHTE6.

⁵ Vendimi V_400_2012 është në dispozicion në faqen e ZRRE-së në www.ero-ks.org (Aktet/Vendimet) 2012.

5 Çështje të tjera

5.1 Shpenzimet kapitale nga divizioni i gjenerimit

Në Raportin e vet Konsultativ, ZRRE ka tërhequr vëmendjen te shpenzimet kapitale të propozuara nga KEK-u në divizionin e gjenerimit duke thënë se këto ishin shumë të larta krahasuar me nivelet e realizuara në vitet paraprake dhe se KEK-u qartazi kishte planifikuar t'i financojë këto shpenzime nga rrjedha e parave pa ndonjë financim të jashtëm. ZRRE ka kërkuar që KEK-u të ofrojë informata të mëtejme mbi përbërjen e këtyre shpenzimeve dhe marrëveshjeve të planifikuara financiare. KEK-u nuk ka ofruar informata të kërkuara.

ZRRE ka deklaruar në Raportin Konsultativ se, në mungesë të informatave të tilla, ZRRE do të reduktojë shpenzimet e propozuara kapitale për gjenerim dhe t'i sjell këto në nivele të cilat mund të konsiderohen si më reale. ZRRE konsideron që niveli i investimeve të realizuara kapitale në vitin 2011 reflekton më së miri mundësinë e KEK-ut për të implementuar investime kapitale në ETR6. Rrjedhimisht, ZRRE ka azhustuar nivelin e lejuar të KEK Gjenerimit për investime kapitale prej 60.7 milionë eurosh në 21 milionë euro, që paraqet nivelin e realizuar gjatë ETR5.

Ky azhustim ka ulur MAR-in e KEK Gjenerimit për 3.3 milionë euro.

5.2 Transferi i aseteve 110kV

Në Raportin Konsultativ, ZRRE ka propozuar që kostot e asocuara me bartjen e aseteve 110 kV nga KEK-u te KOSTT-⁶ t'i alokohen KEK-ut, në mungesë të një date të saktë të transferit. Rrjedhimisht, më 12 maj 2012, ZRRE ka pranuar kërkesë nga KEK-u për aprovimin e transferit të këtyre aseteve menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes së transferimit ndërmjet KEK-ut dhe KOSTT-it, më 29 shkurt 2012. Vlerat përfundimtare i janë dorëzuar ZRRE-së më 28 maj 2012.

Duke marrë parasysh këtë, ZRRE propozon që të ndryshojë të hyrat e lejuara tw OSSH-së në kuadër të KEK-ut, për të marrë parasysh këtë transfer të aseteve. Rregullimet e propozuara shfrytëzojnë informatat e pranuar nga KEK dhe janë si në vijim:

- Vlera e zhvlerësuar bruto e aseteve që duhet të transferohen është €14.837 milionë ndërsa zhvlerësimi i akumuluar për këto asete është €3.752 milionë dhe vlera e granteve të shtyera të cilat asocohen me këtë transfer është €5.092 milionë. Neto RAB-i e OSSH-së, rrjedhimisht është ulur për €5.993 milionë.
- Vlera bruto e aseteve pas 2006 që duhet të transferohen është €9.637 milionë dhe zhvlerësimi i akumuluar për këto asete është €2.421 milionë dhe vlera neto e granteve të shtyera të cilat asocohen me këtë transfer është €3.855 milionë. RABf-ja e OSSH-së, e përdorur për të llogaritur fitimin, rrjedhimisht është ulur për €3.355 milionë.

⁶ Në përputhje me Vendimin e Qeverisë 10/29 i datës 3 gusht 2011.

Komentet tjera

- Krahas këtyre aseteve, 130 punëtorë do t'i barten KOSTT-it nga KEK-u. Kostoja vjetore e pagave për këta punëtorë është €875,734. Të hyrat e lejuara të OSSH-së janë ulur rrjedhimisht.
- Kostoja vjetore e mirëmbajtjes e ndërlidhur me këto asete të transferuara është vlerësuar në €250,000. Të hyra e lejuara të OSSH-së janë ulur rrjedhimisht.

Gjithashtu, lejimi për humbje për OSSH-në në kuadër të KEK-ut është ulur kundrejt humbjeve të ndërlidhura me këto asete 110 kV, mbi të cilat përgjegjësia tash do të bartet nga KEK-u te KOSTT-i.

Si pasojë e këtij transferi, ZRRE propozon që të ul neto RAB për OSSH-në për €6.0 milionë dhe neto RABf për €3.4 milionë. Kostoja e lejuar e personelit për OSSH-në do të ulet për €0.87 milionë.

5.3 Rritja e tantimës për thëngjill

Më 25 maj 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar propozimin e Qeverisë për rritjen e tantimës për thëngjill në 3.0 €/ton.

Sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale, pagesat e reja për tantiema të hyjnë në fuqi nga dita e parë e vitit të ardhshëm kalendarik, nëse Vendimi i Kuvendit për ndryshimin e tantimës merret në gjysmën e parë të vitit të tanishëm kalendarik. Kjo nënkupton që rritja e tantimës do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2013 dhe do të ketë ndikim vetëm në 3 muajt e fundit të periudhës së mbuluar nga ky shqyrtim tarifar (1 janar 2013 deri më 31 mars 2013). Për këtë arsye, rritja e përgjithshme në të Hyra të Lejuara në periudhën tarifore të KEK Minerave dhe KEK Gjenerimit si pasojë e rritjes së tantimës për këtë vit do të jetë €5.4 milionë. Kjo vlerë është përfshirë në të hyrat e lejuara për vitin 2012.

6 Komentet tjera

6.1 OJQ Konsumatori

OJQ Konsumatori ka parashtruar komente ku pohon se çfarëdo rritje në tarifat e rregulluara të energjisë elektrike me pakicë është e pajustificuar. Ata pohojnë se:

- KEK-u ka potencial të dukshëm për të ulur kostot duke përmirësuar performansën e vet teknike dhe komerciale. Duhet të bëjë këtë, dhe jo të kërkojë t'ia kalojë koston konsumatorëve në formë të rritjes së tarifave.
- Konsumatorët që paguajnë nuk do të duhej të mbulonin koston e importit për të mbuluar kërkesën nga konsumatorë që nuk paguajnë.
- Konsumatorët në pjesën tjetër të Kosovës nuk do të duhej të paguajnë koston e furnizimit të rrymës në veri të Kosovës.

Komentet tjera

- Qeveria e Kosovës ka obligim të mbrojë konsumatorët nga ndikimi i importit me çmim të lartë.
- Konsumatorë të energjisë elektrike nuk do të duhej të paguajnë tarifa më të larta në mënyrë që të rrisin atraktivitetin e KEK-ut për privatizim.
- KEK-u nuk ia ka dalë mbanë të barazojë rritjen e propozuar të tarifës me garancat për besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit, ashtu siç kërkohet në kontrata me konsumatorë.
- Skema “ABC” duhet të ndërpritet si e padrejtë për konsumatorë që paguajnë të cilët gjenden në zona me klasifikime më të ulëta.
- Bllok tarifa ofron mundësi për manipulim të njehsorëve nga KEK-u dhe duhet të ndërpritet.

Përgjigjet e ZRRE-së ndaj secilit prej këtyre komenteve është dhënë në vijim:

- Propozimet e ZRRE-së marrin parasysh vlerësimin e vet mbi aftësinë e KEK-ut për të përmirësuar performancën. ZRRE pret përmirësime domethënëse të efikasitetit nga KEK-u dhe i ka larguar ato kosto të cilat i konsideron si të pajustificuara.
- Nëse qeveria nuk zotohet për të financuar ndonjë mungesë fondesh, ZRRE duhet të miratojë tarifat të cilat janë të atij niveli që i lejojnë KEK-ut të mbulojë kosto efikase dhe të arsyeshme duke marrë parasysh pikëpamjet e ZRRE-së mbi nivelin e inkasimit të cilin KEK-u mund të arrijë nëse i ndjek borxhet e këqija në mënyrë agresive. ZRRE-ja nuk mund të përcaktojë një tarifë të aprovuar e cila nuk i lejon KEK-ut të mbulojë kostot e arsyeshme.
- Vendimi për të ofruar furnizime të pafaturuara i takon Qeverisë. Përgjegjësia e ZRRE-së është të kujdeset që, në mungesë të subvencioneve nga Qeveria për të financuar këtë obligim, KEK-u të jetë në gjendje të mbulojë kostot që shkaktohen e të cilat nuk janë në kontroll të KEK-ut.
- Vlerësimi i ZRRE-së për kostot e importeve bazohen në çmimet e vrojtuar të tregut në regjion. Vendimet se deri në ç’masë duhet të ofrohen subvencione për të ndihmuar në financimin e këtyre kostove janë çështje për Qeverinë dhe jo për ZRRE-në.
- Vendimet e ZRRE-së bazohen mbi vlerësimin e saj lidhur me kostot e arsyetuara dhe efikase të KEK-ut dhe jo të përpiqet të arrijë ndonjë vlerë të caktuar të privatizimit. Megjithatë, ZRRE-ja pranon se privatizimi është një pikësypim i politikave të qeverisë dhe se vendimet e saj nuk duhet të bllokojnë arritjen e këtij pikësypimi.
- Tarifat e aprovuara duhet t’i mundësojnë KEK-ut të mbulojë kostot e ofrimit të furnizimit të besueshëm të energjisë elektrike i cili plotëson standardet e cilësisë së shërbimit të përcaktuara nga ZRRE.

Komentet tjera

- Shfrytëzimi i mekanizmit “ABC” ka ndihmuar në përmirësimin e normës së inkasimit. ZRRE është e vetëdijshme për shqetësimet lidhur me natyrën potencialisht të padrejtë dhe vazhdimisht shqyrton vazhdimin e përdorimit të mekanizmit.
- Blllok tarifa synon të sigurojë që furnizimi i energjisë elektrike të jetë më i lirë për amvisëri të varfra. Nevoja e vazhdueshme për blllok tarifa është në shqyrtim e sipër nga ZRRE-ja. Në rastet kur ekzistojnë dëshmi mbi keqpërdorim të tarifës, këto fillimisht duhet t’i raportohen KEK-ut dhe rrjedhimisht ZRRE-së nëse ankesa nuk zgjidhet si duhet.

6.2 SHUKOS

SHUKOS kanë parashtruar komente ku ngritin shqetësimin e tyre mbi ndikimin e rritjes së tarifës në koston e furnizimit me ujë në Kosovë dhe propozon që këto të zbuten duke definuar stabilimentet për pastrim të ujit dhe për furnizim si një klasë speciale e konsumatorëve strategjik, ku tarifat më të ulëta do të pasqyrojnë natyrën e ngarkesës fillestare të kërkesës së tyre.

ZRRE thekson se SHUKOS ka ofruar komente të ngjashme edhe në SHTE4 (për tarifat prej 2010-11). ZRRE atëherë pati deklaruar se SHUKOS duhet të parashtrrojë KEK-ut propozimin për ta amandamentuar strukturën tarifore. KEK-u pastaj ka përgjegjësinë që ta paraqesë propozimin për aprovim tek ZRRE. Nëse SHUKOS i ka bërë një propozim të këtillë KEK-ut dhe nuk është i kënaqur me përgjigjen e pranuar, ata mund të parashtrojnë ankesë tek ZRRE sipas mekanizmave në fuqi për zgjidhjen e kontesteve.

6.3 Shoqata e Mullistëve të Kosovës

Shoqata ngritë shqetësimet vijuese:

- Prej 98 mullinjve në Kosovë, vetëm 58 janë në funksion. Shkak për këtë shoqata nxjerr tarifat e larta të energjisë elektrike dhe vlerëson se gjysma e mullinjve të mbetur do të mbyllen nëse tarifat e energjisë elektrike rriten edhe më tej, që do të rrisë importin e miellit dhe bukës.
- Ky presion ju shtohet disavantazheve të tjera për mullinjtë e Kosovës krahasuar me ato në regjion. Këtu përfshihen norma më të larta të TVSH-së dhe mungesa e rezervave shtetërore të grurit.

Shoqata propozon që:

- Të vendoset theks më i madh në nevojën që KEK-u të ul koston e vet duke përmirësuar efikasitetin.
- Të përcaktohet një tarifë e veçantë dhe më e ulët për mullinjtë, duke pasuar shembullin e Maqedonisë.

ZRRE thekson se tatimet në produkte ushqimore dhe domosdoshmëria e uljes së importit të ushqimeve janë çështje të politikës qeveritare dhe jo e ZRRE-së. Përgjegjësia e ZRRE-së është të aprovojë tarifa të energjisë elektrike kur nuk ka konkurrencë efektive dhe këto tarifa të mbulojnë koston efikase dhe të arsyeshme të furnizimit me energji elektrike dhe që këto tarifa të reflektojnë kostot. Përkitazi me propozimet e Shoqatës, ZRRE i referon ata tek përgjigjet e ofruara për OJQ Konsumatori dhe SHUKOS që janë dhënë më lartë.

7 Të hyrat e lejuara të propozuara si dhe rritja mesatare e nevojshme e tarifës

Vlerësimi i KEK-ut është që përshtatjet e nënkuptuara nga komentet e tyre (një reduktim në shumën e bashkërenduar midis kostove të realizuara dhe të lejuara O&M në vitin 2011 dhe uljen e të hyrave të lejuara sipas Vendimit të ZRRE-së V_400_2012) do të rriste të hyrat e lejuara të mbledhura nga FPEE-së për 8.6 milionë euro krahasuar me propozimet fillestare të ZRRE-së.

Vlerësimi i ZRRE-së mbi përgjigjet e ofruara nga KEK-u është se këto nuk e justifikojnë asnjë modifikim të propozimeve fillestare të të hyrave të lejuara për bizneset e licencuara të KEK-ut, ashtu siç janë dhënë në Raportin Konsultativ të ZRRE-së. Përshtatjet janë të nevojshme për të hyrat e lejuara për të licencuarit individualë për të marrë parasysh transferimin e asetëve 110 kV nga KEK-u në KOSTT. Është gjithashtu e nevojshme të azhurnohet llogaritja e të hyrave të lejuara për të marrë parasysh propozimet e ZRRE-së mbi MAR që do të mbulohet nga KOSTT-i (shih Raportin e veçantë të përgjigjeve të lëshuar lidhur komentet e marra lidhur me konsultimin e ZRRE-së mbi aplikacionin e KOSTT-it). Të Hyrat e Lejuara të Gjenerimit dhe minierës duhen rritur për 5.4 milionë euro për të reflektuar rritjen e tantimës dhe ndikimin e saj nga 1 janari 2013.

ZRRE-ja propozon që tarifat mesatare për konsumatorët e rregulluar të rriten për 8.9 %, pasi të merret parasysh rritja e pritur e shitjeve me tarifat e rregulluara me pakicë.

Një përmbledhje e aplikacioneve fillestare të pranuar nga KEK-u dhe KOSTT-i, propozimet fillestare të përfshira në Raportin Konsultativ të ZRRE-së, propozimet e KEK-ut, ashtu siç janë dhënë në komentet e tyre, dhe propozimet e ZRRE-së të përcaktuara në përputhje me këtë Raport të përgjigjeve janë dhënë më poshtë.

Edhe pse tarifat e reja do të hyjnë në fuqi nga data 1 qershor 2012, llogaritja në tabelën e sipërme është bërë nën supozimin se ato do të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2012 për të pasur bazë konsistente të krahasimeve me aplikacionet dhe propozimet fillestare. **Ndryshimi që rrjedhë si pasojë e vonësës 2-mujore të implementimit të tarifave të reja do të rikonsillohet në shqyrtimin e ardhshëm tarifor (SHTE7) në vitin 2013.**

Të hyrat e lejuara të propozuara si dhe rritja mesatare e nevojshme e tarifës

Tabela 3: Përmbledhja e kërkesave dhe propozimeve mbi tarifaf e rregulluara

<i>Milionë € përveç nëse ceket ndryshe</i>	Të lejuar për 2011	Kërkesa	Propozimi fillestar i ZRRE-së	Komentet e KEK-ut	Propozimet e ZRRE-së
Gjenerimi i KEK-ut					
Kostoja O&M pa zhvlerësim (a)		39.0	30.3	30.3	30.3
Zhvlerësimi		18.7	20.2	20.2	18.9
Kthimi i lejuar		18.8	12.0	12.0	10.2
Kostoja e furnizimit me linjit		74.2	65.1	65.1	70.4
Taksa për KOSTT-in		3.3	2.7	2.7	2.7
Të hyrat e parregulluara		-0.3	-0.3	-0.3	-0.3
Ndryshime të tjera		-0.7	-3.5	0.0	-3.5
MAR për gjenerim	120.8	152.9	126.4	130.0	128.7
Kostot e tjera të furnizimit me energji elektrike					
Kostoja e blerjes së energjisë elektrike jashtë KEK-ut		4.5	4.5	4.5	4.5
Importi		57.7	60.1	60.1	59.8
Eksporti		-5.1	-8.3	-8.3	-8.3
Kostoja totale e furnizimit	170.4	210.0	182.7	186.3	184.8
KOSTT OST + OT					
Kostoja O&M pa zhvlerësim		9.5	5.3	5.3	6.4 (b)
Zhvlerësim		5.3	4.3	4.3	4.7 (b)
Kthimi i lejuar		1.9	2.2	2.2	2.6 (b)
Blerja e humbjeve në transmision		4.1	3.9	3.9	4.4 (b)
Të hyrat e parregulluara		0.0	0.0	0.0	0.0
Ndryshime të tjera		-0.3	-0.7	-0.7	-0.7
KOSTT MAR	12.8	20.5	14.9	14.9	17.3
KEK OSSH					
Kostoja O&M pa zhvlerësim (a)		16.5	16.5	16.5	15.3 (b)
Zhvlerësimi		5.6	6.1	6.1	5.6 (b)
Kthimi i lejuar		7.8	7.8	7.8	7.4 (b)
Blerja e humbjeve në shpërndarje		61.9	46.5	46.5	46.4 (b)
Të hyrat e parregulluara		-2.8	-2.8	-2.8	-2.8

Të hyrat e lejuara të propozuara si dhe rritja mesatare e nevojshme e tarifës

<i>Milionë € përveç nëse ceket ndryshe</i>	Të lejuar për 2011	Kërkesa	Propozimi fillestar i ZRRE-së	Komentet e KEK-ut	Propozimet e ZRRE-së
Ndryshime të tjera		-0.4	-3.3	-1.7	-3.3
MAR-i KEK OSSH	70.7	88.6	70.8	72.3	68.7
KEK FPEE					
Blerja e energjisë elektrike		210.0	182.7	186.3	184.8
Ngarkesat e KOSTT dhe OSSH-së		105.7	83.0	84.5	83.3
Kostoja O&M me përjashtim të zhvlerësimit (a)		13.6	14.4	14.4	13.6
Zhvlerësimi		1.0	1.1	1.1	1.1
Margjina e shitjes me pakicë		10.5	5.5	5.5	5.5
Lejimet për borxhin e keq		12.0	10.7	10.7	10.8
Shitja e humbjeve të energjisë elektrike		-66.0	-50.4	-50.4	-50.8
Të hyrat e tjera të parregulluara (c)		-16.5	0.0	0.0	0.0
Subvencionet për import		-13.5	-13.0	-13.0	-13.0
Zbatimi i Vendimit V_400_2012		0.0	-4.2 (d)	0.0	-4.2 (d)
Ndryshime të tjera		-11.7	-15.5	-15.5	-15.5
MAR-i KEK FPEE	180.3	245.1	213.9	223.2	215.6

Shënime

- Kostoja e shërbimeve të korporatës që ofrohen nga Zyra Kryesore e KEK-ut alokohen për të gjitha bizneset e licencuara të KEK-ut.
- Ky ndryshim rezulton nga inkorporimi i transferim të aseteve 110 kV nga KEK-u te KOSTT-i si dhe transferin e stafit dhe humbjeve të ndërlidhura.
- Të hyrat e parregulluara përfshijnë shitjen e energjisë vetanake nga FPEE-ja e KEK-ut tek Gjenerimi i KEK-ut dhe Mihja e KEK-ut, në përgatitje të privatizimit të FPEE-së të KEK-ut. Këto transfere interne përjashtohen nga propozimet e ZRRE-së.
- Ndryshimi përfshin një kamatë të llogaritur me 7% në vit.
- Tarifa mesatare aktuale e dhënë nga KEK-u.
- Kjo nuk përputhet me rritjen e llogaritur nga KEK-u në komentet e veta, pasi që për këto është përdorur një vlerë e pasaktë për propozimet fillestare të ZRRE-së. Rregullimet e zbatuara për llogaritjen e të hyrave të lejuara janë ato që propozohen nga KEK-u në komentet e veta.

Kontributet më të mëdha për rritjen e të hyrave të lejuara të FPEE-se janë rritja e pritur e koston së importit krahas rritjes së kërkesës dhe çmimit të importit, uljes së subvencioneve që i paguhen FPEE-së nga Buxheti i Kosovës dhe rritja e tantimës për thëngjill nga janari i vitit 2013 si dhe rritja e MAR-

Tarifat e reja të propozuara

pasojë e përfshirjes së aseteve të viteve para 2006 në RAB për qëllim të llogaritjes së zhvlerësimit⁷. Vëllimi i importit, çmimet e tij, subvencionet e zvogëluara dhe rritja prej 1011% e tantimës për thëngjill janë në masë të madhe larg kontrollit të të licencuarve apo të ZRRE-së. Pasqyra e dallimit ndërmjet të hyrave të propozuara të lejuara për FPEE në vitin 2012 dhe atyre të lejuara për 2011 është dhënë në vijim.

Tabela 4: Pasqyra e ndryshimeve të të hyrave të lejuara maksimale për FPEE

Milionë €	Të lejuara për 2011	Draft propozimet e ZRRE-së	Ndryshimi i lejuar nga 2011
KEK FPEE MAR	180.3	215.6	
Rritja e tantimës për thëngjill (nga 1 janari)		5.4	3.0%
Ndryshimi i MAR për Gjenerimin e KEK-ut		7.9	4.4%
Ndryshimet në koston tjetër të blerjes së energjisë elektrike		6.4	3.5%
Ndryshimi në MAR-in e KOSTT		4.5	2.5%
Ndryshimi në MAR-in e OSSH-së KEK		-2.0	-1.1%
Ndryshimi në lejin për borxhet e këqija		5.8	3.2%
Ulja e subvencioneve për import		14.4	8.0%
Zbatimi i Vendimit V_400_2012		-4.2	-2.3%
Ndryshimet tjera në MAR të FPE-së KEK		-2.9	-1.6%

8 Tarifat e reja të propozuara

KEK-u pajtohet me ZRRE-në se nuk ka kohë të mjaftueshme që në kuadër të shqyrtimit ekzistues të merren në konsideratë edhe ndryshimet në strukturën e tarifave të rregulluara me pakicë. KEK-u pohon se ka prova të mjaftueshme se tarifat e konsumatorëve shtëpiak janë nën koston e furnizimit, dhe që duhen rritur më shumë se ato të kategorive të tjera të konsumatorëve në mënyrë që të fillojë procesi i lëvizjes së të gjitha tarifave drejt niveleve që pasqyrojnë koston. KEK-u s’thekson se, pas këtij shqyrtimi, janë vetëm edhe dy vjet të tjera gjatë të cilave tarifat e konsumatorëve shtëpiak mund të rriten në nivele që pasqyrojnë koston për të përmbushur kërkesën ligjore që kjo të bëhet deri më 31 dhjetor 2014. Sa më shumë që kjo vonohet, më e lartë do të jetë nevoja për rritje në shqyrtimet e ardhshme për të përmbushur këtë kërkesë. KEK-u, në komentet e veta, propozon që tarifat për konsumatorët jo-shtëpiak të rriten pa dallim për 5% ndërsa tarifat për konsumatorët shtëpiak pastaj të rriten për shumën e nevojshme për të siguruar në tërësi të hyrat e lejuara për FPEE. Llogaritjet e

⁷ Qasja e kaluar ka qenë që këto asete të mos përfshihen në RAB me argumentin se ishin marrë “falas”. Ligji për Rregullatorin e Energjisë i vitit 2010 kërkon që tash e tutje këto asete të përfshihen në RAB.

Tarifat e reja të propozuara

KEK-ut janë që për këtë do të nevojitet një rritje prej 19% e tarifave për konsumatorët shtëpiak me njehsorë dy-tarifor dhe 14% për konsumatorët e tjerë shtëpiak.

ZRRE-ja vlerëson se lëvizja në drejtim të tarifave që reflektojnë koston është obligin ligjor dhe nënkupton rritje më të madhe të tarifave për konsumatorët shtëpiak se sa për konsumatorët e tjerë. Megjithatë, ZRRE-ja mbetet e shqetësuar se niveli i tarifës që pasqyron koston për amvisëri mbetet ende i paidentifikuar.

Duke pasur parasysh këtë pasiguri, ZRRE-ja propozon të rriten të gjitha tarifat e rregulluara me të njëjtën përqindje, duke nënkuptuar një rritje të përbashkët prej 8.9%.